Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria-Vlada-Government*
**Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health**
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Ured Stalnog Sekretara/Office of the Secretary General

02 05-6170
-262- 05 10 23

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | **04.10.2023** |
| **PËR/ZA/TO:** | Znj.Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme |
| **NGA/OD/FROM:** | Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm-Ministria e Shëndetësisë |
| **CC/** | Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë<br>Z.Demë Rexhepi, Udhëheqës i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, Ministria e Shëndetësisë<br>Znj.Kadrije Berisha-Zyrtar Kryesor Financiar, Ministria e Shëndetësisë |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Raporti mbi nivelin e administrimit dhe zbatimit të rekomandimeve të dalura nga raporti i zyrës kombëtare të auditimit për PVF të vitit 2022 për Ministrin e Shëndetësisë |

E nderuar znj.Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme

Bazuar në Rregulloren e punës për zbatimin e Auditimit të planeve të veprimit e miratuar nga Auditori i Përgjithshëm neni 14 pika 5, pas hartimit të Planit të Veprimit, entiteti i auditori i dorëzon Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve. Raportet dorëzohen dy herë në vit, respektivisht deri me 30 Shtator dhe 15 Mars. Bashkangjitur gjeni Raportin për Ministrinë e Shëndetësisë respektivisht nivelin e Adresimit dhe Zbatimit të rekomandimeve të dalura nga raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për PVF të vitit 2022.

Me respekt,

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria-Vlada-Government***
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

---

# RAPORT PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE 2022 TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

Prishtinë
Shtator , 2023

| Nr. | Komponenti i auditimit (kapitulli) | Gjetja | Rekomandimi | Veprimet e ndërmarra | Statusi i zbatimit | Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | Sipas nenit 49 të Ligjit të Punës nr.03/L-2012, femra e punësuar ka të drejtën e pushimit të lehonisë deri në një vit. Gjashtë (6) muajt e parë pagesa bëhet nga punëdhënësi, tre (3) muaj nga Qeveria dhe tre (3) muajt e fundit pushimi i lehonisë është pa pagesë. Për të përfituar të drejtën e kompenzimit për tre (3) muaj nga Qeveria sipas nenit 5 të UA nr. 01/2018, e punësuara duhet të plotësoj formularin zyrtar dhe t'ia bashkangjes edhe Vendimin e lëshuar nga punëdhënësi për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë në kohëzgjatje prej nëntë (9) ose dymbëdhjetë (12) muajsh. Mangësitë e identifikuara janë si në vijim:<br>• Tri raste të specializanteve të rregullta kishin shkuar në pushim të lehonisë pa vendim nga MSH-ja. Në mungesë të vendimit të pushimit të lehonisë, specializantet nuk kanë mundur t'i dorëzojnë dokumentet për të përfituar të drejtën e pushimit me pagesë edhe për tre (3) muajt tjerë nga Qeveria; • Një specializante ishte paguar nëntë muaj nga MSH-ja (tre muaj më shumë) me 70% të pagës | **Rekomandimi B1**<br>Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar monitorim të vazhdueshëm të punonjësve/specializantëve ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Duhet të nxirren vendimet e pushimeve të lehonisë në mënyrë që specializanteve mos t'iu mohohet e drejta e kompenzimit të shtesave nga Qeveria. Në rastet e tejkalimeve duhet të aplikohet ndalesa në pagë për të korigjuar dhe evituar dëmtimin e buxhetit për vlerën e tejkaluar. | 1. Lëshimet e Vendimeve për pushim të lehonis nga Bordi për Shkollim Specialistik.<br>2. Gjatë procesit të auditimit është bërë korigjimi në ndalesa në pagë.<br>3. Dëshmi të vijushmërisë<br>4. Draft Vendimi i pushimit të lehonisë<br>5. Dëshmit e kujdestarive | E zbatuar | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | bazë, duke mos i aplikuar ndalesën e pushimit të lehonisë, ndalesën e shujtës dhe shtesës për Covid 19. Po ashtu, edhe në dy raste tjera shujta dhe shtesa për Covid 19 nuk i ishte ndalur specializanteve që ishin në pushim të lehonisë; dhe • Ministri me datë 09.03.2022 kishte nxjerrë vendim për pagesën e dy (2) kujdestarive obligative në muaj për specializantët dhe që pagesa duhet të aplikohet në mënyrë retroaktive nga muaji Janar 2022. Ne kemi vërejtur që në katër (4) raste janë paguar më shumë se dy kujdestari për disa muaj. Në listat e pranuara nga SHSKUK kishte pagesa deri në katër kujdestari. Vlera e gabimit ishte 5,855€. Menaxhimi i dobët ishte rezultat i mungesës së kontrolleve për specializantët nga ana e zyrtarëve përgjegjës të ministrisë. Pas shqyrtimit nga ekipi i auditimit të gabimeve dhe tejkalimeve në pagesa, zyrtarët përgjegjës kanë filluar të aplikojnë ndalesat në paga nga viti 2023. | | | | |
| 2 | | Proceset e prokurimit publik duhet të zhvillohen në pajtim me kërkesat e LPP-së, udhëzuesit e prokurimit, kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Në identifikuam se:<br>• Në aktivitetin e ri-tenderimit "Furnizim me dokumente shëndetësore–receta për institucionet shëndetësore" anëtar i komisionit për vlerësimin e tenderit ishte caktuar | **Rekomandimi A1**<br>Ministri duhet të siguroj që ndarja e detyrave dhe dosja e tenderit të përgatitet në mënyrë të tillë që të mos ketë nevojë të ndryshohen kërkesat gjatë procesit, me propozime të ofertuesve. Po ashtu, vendimet për menaxher të kontratës | 1. Gjatë viti 2022 ka qene vetëm një kontratë e cila nuk ka pasur vendim të menaxherit nga ZKA, vlera e kontratës është 32,340.00€.<br>2. Ministria e Shëndetësisë për nevoja të brendeshme do te monitoroj | **E zbatuar** | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | zyrtari i cili kishte përgatitur specifikat. Kjo është në kundërshtim me nenin 62 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit (RrUOP) te ndarja e detyrave pika 62.3, paragrafi 4. Ky aktivitet kishte filluar me 08.03.2021 dhe kishte rezultuar me kontratë me 30.09.2022. Po ashtu, në të njëjtin aktivitet të prokurimit ishte krijuar konfuzion te Operatorët Ekonomik (OE) në lidhje me çmimin që duhet ofertuar pas pikës dhjetore. Në fillim në dosje të tenderit ishte kërkuar që çmimet të jenë me dy shifra pas pikës dhjetore, më vonë me katër, pastaj në fund një pjesë e artikujve me dy e pjesa tjetër me katër. Të gjitha këto ndryshime kishin ardhur pas kërkesave të OE si rezultat i specifikimeve që ishin bërë në dosje të tenderit; dhe<br>• Në procedurën e prokurimit "Blerja e paisjeve medicinale për DSHB" (vlera e kontratës 32,340€) mungon vendimi nga ZKA për caktimin e menaxherit te kontratës, siç kërkohet me nenin 61.15 të RrUOP-së. Ndarja jo e duhur e detyrave, mungesa e analizave gjatë përgatitjes së specifikave dhe mungesa e vendimit nga ZKA për caktimin e menaxherit të kontratës tregojnë një kujdes jo të duhur të akterëve të involvuar në mbarëvajtjen e proceseve të prokurimit. | duhet të autorizohen nga ZKA-së. | inicimet e tenderëve në baza periodike.<br>3. Dëshmi nga divizioni i Prokurimit .<br>4. Dëshmit për menaxher të kontratave. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **3** | | Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimit të mallit bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura. Ne identifikuam tri raste/pagesa, ku zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të shërbimeve/faturës (vonesat në zotime ishin nga një deri në pesë muaj). Këto shërbime ishin për mirëmbajtje të teknologjisë informative dhe shfrytëzim i automjeteve me qira. Totali i këtyre pagesave ishte 26,829€. Kjo ka ndodhur për shkak të praktikës jo adekuate për të zbatuar procedurat ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës. Mirëpo, sipas ZKF-së për disa shërbime tjera specifike kjo mund shkaktoj pengesë në efikasitetin e operimit. | **Rekomandimi A2**<br>Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkojë zbatimin e procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave | 1. Zotimet të bëhen nga muaji Korrik, per 3 muaj.<br>2. Menaxheri i kontratës obligohet për çdo shërbim të procedoj kërkesën për urdhërblerje në Departamentin e Prokurimit me të dhënat përkatëse të kontratës dhe zotimit.<br>3. Do të përpilohet Lista kontrolluse për të gjithë menaxherët e kontratave për gjenerim të urdhërblerjes.<br>4. Dëshmi që Ministria e Shëndetësisë ka kërkuar për ndërprerje të kontratës. | **<u>Në proces</u>** | |
| **4** | | Autoriteti Kontraktues (AK) në përputhje me pikën 30.8 të RrUOPP, do të konfiskoj sigurimin e ekzekutimit në rast të shkeljes së kontratës së nënshkruar nga OE, e cila i ka shkaktuar dëme materiale dhe kur AK duhet të shkaktoj shpenzime shtesë për përfundimin e kontratës së tillë. Në kontratën "Furnizim me pajisje të IT për nevoja të MSh-së" në vlerë prej 10,780€, pas nënshkrimit të kontratës, OE ka dështuar t'i përmbushë kushtet kontraktuale. Pas | **Rekomandimi A3**<br>Ministri duhet të sigurohet përmes menaxherëve përkatës se në rastet kur dështon përmbushja e kontratës nga ana e OE pa ndonjë justifikim të bazuar të aplikohen masat e parapara ndëshkuese sepse këto devijime parandalojnë në arritjen e objektivave të synuara. | 1. Ministria e Shëndetësisë do të montioroj përmes menaxherëve të kontratës në menyr sistematike ekzekutimin e kontratave.Mungesa e ekzekutimit ka qenë për rastin në vler financiare 1,078€.<br>2. Dëshmi nga divizioni i Prokurimit për | **<u>E zbatuar</u>** | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kësaj situate MSH ka njoftuar me shkrim OE, për shkëputjen e kontratës, por nuk ka bërë konfiskimin e sigurimit të ekzekutimit (10%) që ishte valid për këtë periudhë në emër të mospërmbushjes së kontratës. Kërkesa për konfiskimin e sigurisë ishte bërë vetëm një (1) ditë para skadimit të afatit. Kjo kishte ndodhur nga pakujdesia për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës dhe përcjelljes së procesit të tërheqjes së sigurimit të ekzekutimit në afatin ligjor. | | konfiskim te Garancioneve të Ekzekutimit. | | |
| <u>5</u> | | Sipas nenit 18, pikës 3 të rregullores financiare nr. 01/2013-shpenzimi i parasë publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate ekonomike, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë të regjistruara në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. Ne identifikuam që gjatë vitit 2022 Ministria ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 90,040€ në kategori ekonomike jo adekuate, të cilat janë të paraqitura në vijim:<br>• Furnizimi me frigorifer dhe shtretër mjekësorë në vlerë prej 32,340€ ishte buxhetuar dhe paguar nga kategoria e investimeve kapitale. Vlera prej 16,500€ i takon kategorisë nga e cila janë paguar, ndërsa pjesa tjetër prej 15,840€ janë paisje mjekësore nën | **Rekomandimi C1**<br>Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorisë. | 1. Do të tentohet që të hartohet një plan më i detajuar i buxhetit në mënyrë që të shmangim klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve.<br>2. Dëshmi dy kontrata dhe shpenzimet sipas kategorive të planifikuara. | <u>**E zbatuar**</u> | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1,000€ dhe të njëjtat i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime; dhe<br>• Blerja e pajisjeve laboratorike në vlerë prej 99,900€ ishte buxhetuar dhe paguar nga kategoria e investimeve kapitale (klauzola e investime). Prej tyre vetëm 25,790€ i takojnë investimeve kapitale, ndërsa pjesa prej 74,200€ i takon kategorisë së mallra dhe shërbime, sepse janë paisje nën 1,000€. Këto keqklasifikime në pagesa kishin ndodhur si pasojë e planifikimit të gabuar në ndarjet me ligjin e buxhetit. | | | | |
| 6 | | Sipas nenit 6, pika 3 të Rregullores së MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa ajo jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "epasuria". Kurse neni 5 percakton klasifikimin që duhet aplikuar për regjistrimin e pasurive, dhe neni 22 i të njejtës rregullore pëcakton normën e zhvleresimit. Në PFV kemi nënvlerësim të pasurisë për 4,304€ (pasuritë e mbivlerësuara ishin për 28,020€, ndërsa të nënvlerësuara për 32,324€). Informatat në detaje mund të shihen në vijim:<br>• Te neni 19, Raporti për pasuritë jofinanciare - vërehet se në PFV kishte mbivlerësim të pasurisë jo kapitale për 28,020€. Kjo ishte rezultat i përfshirjes në raportim edhe të disa | **Rekomandimi B2**<br>Ministri duhet të sigurojë se të gjitha njësitë brenda MSH-së bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurisë në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale. | 1. Sa i përket Ministrisë së Shëndetësisë janë ndërmarr hapa që e gjetura mos të përseritet. Zbatimi i plotë i rekomandimit është sfidues për arsye se sistemi e-pasuria menaxhohet nge ASHI, përderisa zyrtarët përgjegjës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe njehësive vartëse të saj hasin në vështersi gjatë aplikimit të sistemit si:<br>• Bartja e pasurisë nga zyrtari në zyrtar,<br>• Ndërprerja e vazhdushme në | **Në proces** | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pasurive nën 1,000€ që i takonin blerjeve të vitit 2023 (kjo kishte ndodhur te administrata e MSH-së, dhe AKPPM si rezultat ndryshimet e aplikuara në sistemin e-pasuria);<br>• Furnizimi me 92 komodina medicionale për DSHB, në vlerë prej 17,655€ nuk ishte regjistruar në sistemin e-Pasuria;<br>• Furnizimi me kompjutera, të pranuar në gusht 2022 në vlerë prej 14,669€ nuk ishte regjistruar në regjistrin e-pasuria, e si të tilla nuk figuronin as në regjistrin e stoqeve; dhe<br>• Paisjet speciale mjekësore në vlerë prej 65,330€ ishin klasifikuar me normën jo adekuate të zhvlersimit. Dobësitë në regjistrin kontabël të pasurive kanë ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme, për sa i përket fushës së pasurive dhe mos komunikimit të duhur në mes të njësive vartëse në kuadër të MSH-së. | | sistem, pengesa teknike,<br>• Përshkak të ndërprejes të kohëpaskohshëm pamundësia e gjenerimit te raporteve,<br>• Mospranimi i trasfereve të jashtme nga institucionet.<br>• Dëshmit Pasqyrat e regjistrimit ne E-pasuri dhe Freebalanc te blerjeve kapitale te DSHB për 2023.<br>• Mos funksionimi i sistemit të E-pasurisë.<br>2. Dëshmi:<br>• Raportin e Shpenzimeve për projekte kapitale nën 1000 euro dhe mbi 1000;<br>• Dokumentacionin e shpenzimit;<br>• Dëshmit e regjistrimit në E-pasuri dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • Dëshmit e regjistrimit në SIMFK për shpenzimet e vitit 2023. | | |
| 7 | | Sipas rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, neni 6- organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare. Vlera e prezantuar llogarive të arkëtueshme në PFV ishte 973,457€, ndërsa sipas raporteve individuale ishte 935,656€. Kjo diferenc ishte gjatë konsolidimit të të arkëtueshmeve në mes njësisë qëndrore dhe njësive vartëse, ku nga Programi i Inspektoriatit Farmaceutik kishte dyfishim të Ll/A. Si rezultat i kësaj të arkëtueshmet ishin të mbivlerësuara për 37,801€. Shpalosjet jo të sakta të informatave në PFV tregojnë se kontrollet gjatë procesit të konsolidimit të të arkëtueshmeve nuk janë mjaftueshëm efektive për shkak të një kordinimi jo shumë të mire në mes njësive vartëse dhe administratës qendrore. | **Rekomandimi A4**<br>Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave një koordinim më efektiv në mes njësive (programeve) me qëllim që gabimet e tilla të mos përsëriten gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit 2023. Po ashtu, Pasqyrat financiare para se të dorëzohen në Thesar duhet t'i nënshtrohen një rishikimi dhe kontrolli të detajuar nga ana e menaxhmentit. | 1. Ministrisë së Shëndetësisë do të monitoroj në baza mujore llogarit e arkëtushme përmes raportimit përmes arkivës.<br>2. Dëshmi raporti i te arkëtushmeve nga DLIPSH. | **E zbatuar** | |

RAPORT PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE 2022 TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

**Gjetja:**

Sipas nenit 49 të Ligjit të Punës nr.03/L-2012, femra e punësuar ka të drejtën e pushimit të lehonisë deri në një vit. Gjashtë (6) muajt e parë pagesa bëhet nga punëdhënësi, tre (3) muaj nga Qeveria dhe tre (3) muajt e fundit pushimi i lehonisë është pa pagesë. Për të përfituar të drejtën e kompenzimit për tre (3) muaj nga Qeveria sipas nenit 5 të UA nr. 01/2018, e punësuara duhet të plotësoj formularin zyrtar dhe t'ia bashkangjes edhe Vendimin e lëshuar nga punëdhënësi për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë në kohëzgjatje prej nëntë (9) ose dymbëdhjetë (12) muajsh. Mangësitë e identifikuara janë si në vijim:

- Tri raste të specializanteve të rregullta kishin shkuar në pushim të lehonisë pa vendim nga MSH-ja. Në mungesë të vendimit të pushimit të lehonisë, specializantet nuk kanë mundur t'i dorëzojnë dokumentet për të përfituar të drejtën e pushimit me pagesë edhe për tre (3) muajt tjerë nga Qeveria;

- Një specializante ishte paguar nëntë muaj nga MSH-ja (tre muaj më shumë) me 70% të pagës bazë, duke mos i aplikuar ndalesën e pushimit të lehonisë, ndalesën e shujtës dhe shtesës për Covid 19. Po ashtu, edhe në dy raste tjera shujta dhe shtesa për Covid 19 nuk i ishte ndalur specializanteve që ishin në pushim të lehonisë; dhe

- Ministri me datë 09.03.2022 kishte nxjerrë vendim për pagesën e dy (2) kujdestarive obligative në muaj për specializantët dhe që pagesa duhet të aplikohet në mënyrë retroaktive nga muaji Janar 2022. Ne kemi vërejtur që në katër (4) raste janë paguar më shumë se dy kujdestari për disa muaj. Në listat e pranuara nga SHSKUK kishte pagesa deri në katër kujdestari. Vlera e gabimit ishte 5,855€.

Menaxhimi i dobët ishte rezultat i mungesës së kontrolleve për specializantët nga ana e zyrtarëve përgjegjës të ministrisë. Pas shqyrtimit nga ekipi i auditimit të gabimeve dhe tejkalimeve në pagesa, zyrtarët përgjegjës kanë filluar të aplikojnë ndalesat në paga nga viti 2023.

**Rekomandimi B1**

Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar monitorim të vazhdueshëm të punonjësve/specializantëve ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Duhet të nxirren vendimet e pushimeve të lehonisë në mënyrë që specializanteve mos t'iu mohohet e drejta e kompenzimit të shtesave nga Qeveria. Në rastet e tejkalimeve duhet të aplikohet ndalesa në pagë për të korigjuar dhe evituar dëmtimin e buxhetit për vlerën e tejkaluar.

---

Deshmit e Implementimit:

1. Lëshimet e Vendimeve për pushim të lehonis nga Bordi për Shkollim Specialistik.
2. Gjatë procesit të auditimit është bërë korigjimi në ndalesa në pagë.
3. Dëshmi të vijushmërisë
4. Draft Vendimi i pushimit të lehonisë
5. Dëshmit e kujdestarive

Shtator 2023

**Gjetja:**

Proceset e prokurimit publik duhet të zhvillohen në pajtim me kërkesat e LPP-së, udhëzuesit e prokurimit, kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Në identifikuam se:

- Në aktivitetin e ri-tenderimit "Furnizim me dokumente shëndetësore–receta për institucionet shëndetësore" anëtar i komisionit për vlerësimin e tenderit ishte caktuar zyrtari i cili kishte përgatitur specifikat. Kjo është në kundërshtim me nenin 62 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit (RrUOP) te ndarja e detyrave pika 62.3, paragrafi 4. Ky aktivitet kishte filluar me 08.03.2021 dhe kishte rezultuar me kontratë me 30.09.2022. Po ashtu, në të njëjtin aktivitet të prokurimit ishte krijuar konfuzion te Operatorët Ekonomik (OE) në lidhje me çmimin që duhet ofertuar pas pikës dhjetore. Në fillim në dosje të tenderit ishte kërkuar që çmimet të jenë me dy shifra pas pikës dhjetore, më vonë me katër, pastaj në fund një pjesë e artikujve me dy e pjesa tjetër me katër. Të gjitha këto ndryshime kishin ardhur pas kërkesave të OE si rezultat i specifikimeve që ishin bërë në dosje të tenderit; dhe

- Në procedurën e prokurimit "Blerja e paisjeve medicinale për DSHB" (vlera e kontratës 32,340€) mungon vendimi nga ZKA për caktimin e menaxherit te kontratës, siç kërkohet me nenin 61.15 të RrUOP-së. Ndarja jo e duhur e detyrave, mungesa e analizave gjatë përgatitjes së specifikave dhe mungesa e vendimit nga ZKA për caktimin e menaxherit të kontratës tregojnë një kujdes jo të duhur të akterëve të involvuar në mbarëvajtjen e proceseve të prokurimit.

**Rekomandimi A1**

Ministri duhet të sigurroj që ndarja e detyrave dhe dosja e tenderit të përgatitet në mënyrë të tillë që të mos ketë nevojë të ndryshohen kërkesat gjatë procesit, me propozime të ofertuesve. Po ashtu, vendimet për menaxher të kontratës duhet të autorizohen nga ZKA-së.

---

Deshmit e Implementimit:

1. Gjatë viti 2022 ka qene vetëm një kontratë e cila nuk ka pasur vendim të menaxherit nga ZKA, vlera e kontratës është 32,340.00€.
2. Ministria e Shëndetësisë për nevoja të brendeshme do te monitoroj inicimet e tenderëve në baza periodike.
3. Dëshmi nga divizioni i Prokurimit.
4. Dëshmit për menaxher të kontratave.

Shtator 2023

**Gjetja:**

Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimit të mallit bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura. Ne identifikuam tri raste/pagesa, ku zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të shërbimeve/faturës (vonesat në zotime ishin nga një deri në pesë muaj). Këto shërbime ishin për mirëmbajtje të teknologjisë informative dhe shfrytëzim i automjeteve me qira. Totali i këtyre pagesave ishte 26,829€. Kjo ka ndodhur për shkak të praktikës jo adekuate për të zbatuar procedurat ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës. Mirëpo, sipas ZKF-së për disa shërbime tjera specifike kjo mund shkaktoj pengesë në efikasitetin e operimit.

**Rekomandimi A2**

Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkojë zbatimin e procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.

---

Deshmit e Implementimit:

1. Zotimet të behen nga muaji Korrik, per 3 muaj.
2. Menaxheri i kontratës obligohet për çdo shërbim të procedoj kërkesën për urdhërblerje në Departamentin e Prokurimit me të dhënat përkatëse të kontratës dhe zotimit.
3. Do të përpilohet Lista kontrolluse për të gjithë menaxherët e kontratave për gjenerim të urdhërblerjes.
4. Dëshmi që Ministria e Shëndetësisë ka kërkuar për ndërprerje të kontratës.

**Gjetja:**

Autoriteti Kontraktues (AK) në përputhje me pikën 30.8 të RrUOPP, do të konfiskoj sigurimin e ekzekutimit në rast të shkeljes së kontratës së nënshkruar nga OE, e cila i ka shkaktuar dëme materiale dhe kur AK duhet të shkaktoj shpenzime shtesë për përfundimin e kontratës së tillë. Në kontratën "Furnizim me pajisje të IT për nevoja të MSh-së" në vlerë prej 10,780€, pas nënshkrimit të kontratës, OE ka dështuar t'i përmbushë kushtet kontraktuale. Pas kësaj situate MSH ka njoftuar me shkrim OE, për shkëputjen e kontratës, por nuk ka bërë konfiskimin e sigurimit të ekzekutimit (10%) që ishte valid për këtë periudhë në emër të mospërmbushjes së kontratës. Kërkesa për konfiskimin e sigurisë ishte bërë vetëm një (1) ditë para skadimit të afatit. Kjo kishte ndodhur nga pakujdesia për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës dhe përcjelljes së procesit të tërheqjes së sigurimit të ekzekutimit në afatin ligjor.

**Rekomandimi A3**

Ministri duhet të sigurohet përmes menaxherëve përkatës se në rastet kur dështon përmbushja e kontratës nga ana e OE pa ndonjë justifikim të bazuar të aplikohen masat e parapara ndëshkuese sepse këto devijime parandalojnë në arritjen e objektivave të synuara.

---

Deshmit e Implementimit:

1. Ministria e Shëndetësisë do të monitoroj përmes menaxherëve të kontratës në menyr sistematike ekzekutimin e kontratave. Mungesa e ekzekutimit ka qenë për rastin në vler financiare 1,078€.
2. Dëshmi nga divizioni i Prokurimit për konfiskim të Garancioneve të Ekzekutimit.

**Gjetja:**

Sipas nenit 18, pikës 3 të rregullores financiare nr. 01/2013-shpenzimi i parasë publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate ekonomike, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë të regjistruara në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. Ne identifikuam që gjatë vitit 2022 Ministria ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 90,040€ në kategori ekonomike jo adekuate, të cilat janë të paraqitura në vijim:

- Furnizimi me frigorifer dhe shtretër mjekësorë në vlerë prej 32,340€ ishte buxhetuar dhe paguar nga kategoria e investimeve kapitale. Vlera prej 16,500€ i takon kategorisë nga e cila janë paguar, ndërsa pjesa tjetër prej 15,840€ janë paisje mjekësore nën 1,000€ dhe të njëjtat i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime; dhe

- Blerja e pajisjeve laboratorike në vlerë prej 99,900€ ishte buxhetuar dhe paguar nga kategoria e investimeve kapitale (klauzola e investime). Prej tyre vetëm 25,790€ i takojnë investimeve kapitale, ndërsa pjesa prej 74,200€ i takon kategorisë së mallra dhe shërbime, sepse janë paisje nën 1,000€. Këto keqklasifikime në pagesa kishin ndodhur si pasojë e planifikimit të gabuar në ndarjet me ligjin e buxhetit

**Rekomandimi C1**

Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorisë.

---

Deshmit e Implementimit:

1. Do të tentohet që të hartohet një plan më i detajuar i buxhetit në mënyrë që të shmangim klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve.
2. Dëshmi dy kontrata dhe shpenzimet sipas kategorive të planifikuara.

**Gjetja:**

Sipas nenit 6, pika 3 të Rregullores së MF-Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa ajo jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria". Kurse neni 5 përcakton klasifikimin që duhet aplikuar për regjistrimin e pasurive, dhe neni 22 i të njejtës rregullore pëcakton normën e zhvleresimit. Në PFV kemi nënvlerësim të pasurisë për 4,304€ (pasuritë e mbivlerësuara ishin për 28,020€, ndërsa të nënvlerësuara për 32,324€). Informatat në detaje mund të shihen në vijim:

- Te neni 19, Raporti për pasuritë jofinanciare – vërehet se në PFV kishte mbivlerësim të pasurisë jo kapitale për 28,020€. Kjo ishte rezultat i përfshirjes në raportim edhe të disa pasurive nën 1,000€ që i takonin blerjeve të vitit 2023 (kjo kishte ndodhur te administrata e MSH-së, dhe AKPPM si rezultat ndryshimet e aplikuara në sistemin e-pasuria);

- Furnizimi me 92 komodina medicionale për DSHB, në vlerë prej 17,655€ nuk ishte regjistruar në sistemin e-Pasuria;

- Furnizimi me kompjutera, të pranuar në gusht 2022 në vlerë prej 14,669€ nuk ishte regjistruar në regjistrin e-pasuria, e si të tilla nuk figuronin as në regjistrin e stoqeve; dhe • Paisjet speciale mjekësore në vlerë prej 65,330€ ishin klasifikuar me normën jo adekuate të zhvlersimit. Dobësitë në regjistrin kontabël të pasurive kanë ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme, për sa i përket fushës së pasurive dhe mos komunikimit të duhur në mes të njësive vartëse në kuadër të MSH-së.

**Rekomandimi B2**

Ministri duhet të sigurojë se të gjitha njësitë brenda MSH-së bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurisë në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale.

---

Deshmit e Implementimit:

1. Sa i përket Ministrisë së Shëndetësisë janë ndërmarr hapa që e gjetura mos të përseritet. Zbatimi i plotë i rekomandimit është sfidues për arsye se sistemi e-pasuria menaxhohet nge ASHI, përderisa zyrtarët përgjegjës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe njehësive vartëse të saj hasin në vështersi gjatë aplikimit të sistemit si:

- Bartja e pasurisë nga zyrtari në zyrtar,
- Ndërprerja e vazhdushme në sistem, pengesa teknike,
- Përshkak të ndërprejes të kohëpaskohshëm pamundësia e gjenerimit te raporteve,
- Mospranimi i trasfereve të jashtme nga institucionet.
- Dëshmit Pasqyrat e regjistrimit ne E-pasuri dhe Freebalanc te blerjeve kapitale te DSHB për 2023.
- Mos funksionimi i sistemit të E-pasurisë.

2. Dëshmi:

- Raportin e Shpenzimeve për projekte kapitale nën 1000 euro dhe mbi 1000;
- Dokumentacionin e shpenzimit;
- Dëshmit e regjistrimit në E-pasuri dhe
- Dëshmit e regjistrimit në SIMFK për shpenzimet e vitit 2023.

**Shtator 2023**

**Gjetja:**

Sipas rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, neni 6- organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare. Vlera e prezantuar llogarive të arkëtueshme në PFV ishte 973,457€, ndërsa sipas raporteve individuale ishte 935,656€. Kjo diferenc ishte gjatë konsolidimit të të arkëtueshmeve në mes njësisë qëndrore dhe njësive vartëse, ku nga Programi i Inspektoriatit Farmaceutik kishte dyfishim të L1/A. Si rezultat i kësaj të arkëtueshmet ishin të mbivlerësuara për 37,801€. Shpalosjet jo të sakta të informatave në PFV tregojnë se kontrollet gjatë procesit të konsolidimit të të arkëtueshmeve nuk janë mjaftueshëm efektive për shkak të një kordinimi jo shumë të mire në mes njësive vartëse dhe administratës qendrore.

**Rekomandimi A4**

Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave një koordinim më efektiv në mes njësive (programeve) me qëllim që gabimet e tilla të mos përsëriten gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit 2023. Po ashtu, Pasqyrat financiare para se të dorëzohen në Thesar duhet t'i nënshtrohen një rishikimi dhe kontrolli të detajuar nga ana e menaxhmentit.

---

Deshmit e Implementimit:

1. Ministrisë së Shëndetësisë do të monitoroj në baza mujore llogarit e arkëtushme përmes raportimit përmes arkivës.
2. Dëshmi raportet e te arkëtushmeve.

Shtator 2023